

KËRKESË
Nr. 65, datë 11.1.2020

PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “ARTUR MEHMETI”

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: adresë e pamjaftueshme.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Tiranë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH TR-2019 003347-5, datë 10.9.2019, për subjektin “Artur Mehmeti”, me adresë: Njësia Administrative nr. 5, rruga “Fran Bardhi”, Tiranë, makinë me targa AA 402 ES.

KRYEINSPEKTOR
Areti Beruka

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-TR-2019-003347-5

Datë 9.9.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, në VKM-në nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-TR-2019-003347-2, datë 9.9.2019, inspektim që është zhvilluar në subjektin “Artur Mehmeti”, NIPT: L61401017H, përfaqësues i autorizuar i subjektit “jo prezent”, prej datës 9.9.2019 deri në datën 9.9.2019.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 9.9.2019 dhe e njoftoi në datën 9.9.2019. Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, i ndryshuar, neni 26, pika 14, VKM nr. 379, datë 25.5.2016, shtojca VIII, neni 26, pika 14.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit nr. 7643, datë 2.12.1992, neni 27, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 500 000 lekë

Gjobë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

-
Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Brizita Gramo ID 0401030006

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti “Artur Mehmeti” ka të drejtën e ankimit, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë organit epror të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.